




Pranimi / Dorezimi P. amburo / Predato Received / Delivery	14. 12 2022	viti god year	2
Organ / Njësia Organ / Jednitsa O. / Unit	Ni Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SRIMSHCK	8057 / 2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.963/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.963/2022 të datës 31.10.2022 të parashtruar nga ankuesi nga Mitrovica, më adresë banimi

kundër organit të punësimit Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 14.12.2022, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa A.nr.963/2022 e datës 31.10.2022, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, më datë 31.10.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 6585/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me shenjën AUV-01-539-2022 të datës 27.06.2022 të Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 05.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit të Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë, ndërsa kjo e fundit më datë 05.12.2022 ka përcjell shkresat e lidhur me çështjen në procedurë të shqyrtimit dhe vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokollit 6585/2022 të datës 31.10.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 4531 të datës 28.06.2022; Ankesën e datës 15.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 1013 të datës

03.02.2022; E-malin e datës 31.10.2022 të ankuesit drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; E-malin e datës 05.12.2022 me numër të protokollit 7664/2022 të drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës; E-malin e datës 05.12.2022 të Këshillit të Pavarur drejtuar Vendimin me numër Ref.AUV.01-320/2018 të datës 05.09.2018;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesa pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës konstatoi se ankesa e ankuesit **është e palejuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesi sipas Vendimit me shenjë Ref.AUV.01-320/2018 të datës 05.09.2018 të Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë është transferuar nga pozita e punës "Kordinator i Zyrës Regjionale në Prishtinë" në pozitën e punës "Kordinator i Zyrës Rajonale në Mitrovicë", në kuadër të të njëjtës kategori funksionale dhe gradë. I njëjti me datë 31.10.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër Vendimit me shenjë AUV-01-539-2022 të datës 27.06.2022 të Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, duke pretenduar se ky vendim duhet të nxirret nga Sekretari Permanent i Digasterëve përkatëse në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrisë së Shëndetësisë apo Zyra e Kryeministrit pasi që baza ligjore derivon nga këto dikastere.

Në vështrim të dispozitave ligjore të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë Kolegji konstaton se çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e punës. Andaj, në këtë kuptim si dhe referuar nenit 124 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*, Kolegji i Këshillit vlerëson se me Vendimin e kundërshtuar më ankesë nuk është cenuar ndonjë e drejtë apo interes juridik i ankuesit lidhur me marrëdhënien e tij të punës, rrjedhimisht ky vendim i referohet lëshimit të dokumenteve për regjistrim, aprovim, licencim, pëlqim sanitar, dhe autorizim për marketing, duke përcaktuar si kompetent për lëshimin e tyre Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit të Veterinarisë, kështu që, bazuar në këtë konstatim si dhe në mbështetje të nenit 129 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhë së ankesa A.nr.963/2022 e datës 31.10.2022, e parashtruar nga ankuesi është e palejuar, respektivisht ankuesi nuk ka legjitimitetin e palas në këtë çështje juridike.

Siç u tha me sipër, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda më numër A.nr.963/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri


Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

